

# Besimtari

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër  
Viti III i botimit, Tetor 2009 Nr. 30. Çmimi 20 lekë.  
ëëë.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj

## TOLERANCA NDERFETARE DHE MUSLIMANET QE FALEN NE MES TE RRUGES

**F**esta e Fitër Bajramit sivjet në Shqipëri u festua në mënyrë më festive se herët e tjera, sepse koha e bukur me diell u krijoi me shume mundësi besimtarëve të falnin Bajramin dhe të shkonin tek njëri tjetri për të bërë vizita, ashtu si e kërkon kjo festë e madhnueshme, Fitër Bajrami, ose si quhet ndryshe Bajrami i Ramazanit, vuri në lëvizje edhe politikanët shqiptarë, duke filluar me deputetë, që u kujtuan së paku me rastin e festave për elektoratin që u dha votat dhe i bëri deputetë dhe duke vazhduar me politikanët e rangjeve më të larta të cilët vërshuan nëpër institucionet muslimane duke filluar nga KMSH dhe duke u ulur pastaj nëpër myftinitë e rretheve, ku pa tjetër ne shijeshtë ishte myftinia e Shkodrës ku kësaj rralle për të uruar Fitër Bajramin ishte kryeministri i Shqipërisë Sali Berisha dhe Kryetarja e Parlamentit shqiptar, Jozefina Topalli. Nga pamjet që u transmetuan në mediat lokale dhe kombëtare u pa se zyrtarët e lartë janë pritur nga Myftiu i Qarkut Shkodër Ndricim Sulejmani nga teologu Arben Halluni, sekretari i këshillit të myftinisë Fejzi Zaganjori dhe përfaqësues të lartë të klerit katolik dhe atij ortodoks në Shodër, pa harruar edhe numurin e madh të mediave lokale dhe atyre kombëtare të cilat e përcollën vizitën e udhëheqësve më të lartë të Partisë Demokratike në Myftininë e Qarkut Shkodrës. Si në përsëritjen e Sali Berishës, ashtu edhe në atë të Jozefina Topallit, krahas urimit për Fitër Bajramin u theksua përsëri vlera e tolerancës ndërfetare në Shkodër duke e idealizuar atë në shkallën më të lartë e cila për hir të realitetit duhet pranuar se është prezente në mes të tre religjoneve. Duke shkuar më larg ne idealizimin e kësaj dukurie, u dha mesazhi se është mirë që kjo tolerancë ndërfetare të merret si shembull në shkallë botërore si një dukuri që u shërben atyre popujve që do ta kenë fatin ta aplikojnë. Por si cdo



realitet, kjo dukuri ka edhe anën tjetër të medaljes..Ndërsa flitet për tolerancë ndërfetare dhe pushtetarë e politikanë i japin kësaj tolerancë notat maksimale, nga ana tjetër religjoni musliman është i persekutuar politikisht, mediatikisht dhe ekonomikisht. Kryeministri i qeverisë aktuale deklaroi publikisht se partia, që ai drejton, bazohet tek religjoni katolik që maksimumi kap shifrën 10% dhe që është i përqëndruar maksimalisht në veri, në një kohë që i mohohet roli përcaktues i muslimanëve në lëvizjen demokratike dhe në vetë Partinë Demokratike si avangardë e kësaj partie, pjesë e se cilës është vetë kryeministri aktual shqiptar. Eshte rasti që të theksojmë rolin diskriminues që luajnë mediat shqiptare kundër muslimanëve duke u servirë lexueve dhe teleshikuesve lajme nga bota që denigrojnë muslimanët dhe duke i bërë ata pjesë të terrorizmit dhe e krimeve, veprime që nuk kanë të bëjnë me islamit. Kuptohet se muslimanët nuk mund t'u hedhin lule atyre që

i kanë pushtuar dhe po u vrasin fëmijët dhe po u shkatërrojnë kulturën dhe identitetin e tyre. Sot, në Shqipëri, thuhet janë nxerrë jashtë të gjitha shoqatat e huaja muslimane, të cilat ndihmuan me fonde dhe donacione institucionet muslimane nga ana ekonomike, duke i detyruar institucionet muslimane në Shqipëri që sot të shesin pronat për të mbijetuar ekonomikisht Sot, muslimanëve, po këto pushtetarë, që flasin për tolerancë ndërfetare, nuk po u japin leje të ndërtojnë një xhami në Tiranë ku ato të falen, si i kanë kishat e tyre të stërmëdha katolikët dhe ortodoksët. Edhe sivjet muslimanët në Tiranë e bënë faljen e tyre në mes të rrugës duke marrë edhe diskriminin e rrallës. Kurse myftiu i Tiranës në fjalën e tij para besimtarëve vazhdon justifikimin se islami nuk ka gjë të përbashkët me terrorizmin, në një kohë që duhet t'u kujtonte besimtarëve se ato po fyheshin dhe dikriminoheshin, duke u falur në mes të rrugës. Nuk e dimë a do të kishte muslimanë budallenj në botë që të pranoin

të zbatonin tolerancën ndërfetare shqiptare të cilën po ua servirin atyre politikanë dhe pushtetarë shqiptarë, pa harruar edhe politikanë të lartë të huaj, si nje celes harmonie në mes të religjoneve, e cila faktikisht është një maskë e rrezikshme që drejtohet dhe përdoret kundër interesave të muslimanëve. Një tolerancë e tillë, gjithmonë dhe kudo që ajo do të zbatohet, do të jetë pjesë e portretit të përlules dhe i poshtëritit të muslimanëve. Prandaj, tolerancë e vertetë ndërfetare do të ketë në Shqipëri vetëm atëherë kur dikriminimi politik, ekonomik dhe mediatik kundër muslimanëve të ketë marrë fund, gjë që do të sillte edhe fundin hipokrit të politikës së pushtetit në Shqipëri për tolerancën ndërfetare në mes të religjoneve fetare në Shqipëri dhe se vetëm atëherë mund të flitej për eksportim të tolerancës fetare shqiptare në botë.

Selim Gokaj



# INFORMACIONE NGA "ZERI I TURQISE"

## FESTOHET ME MADHESHTI BAJRAMI I RAMAZANIT NE TURQI

**S**tacioni radiofonik "Zëri i Turqisë" ka dhënë informacione, ku ka theksuar se në Turqi është festuar me madhësi Bajrami i Ramazanit që është festa më e madhe që festojë besimtarët në Turqi. Vecori kryesore e kësaj feste ishin vizitat masive që bënë besimtarët muslimanë tek njëri tjetrin, ku spikatnin vizitat tek të afërmit e tyre,

tek miqtë dhe fqinjët e tyre. Vizita kishte edhe në sferën e politikës, ku politikanët nuk harruan të kujtohen se ditën e Bajramit ato ishin besimtarë të thjeshtë muslimanë dhe se përkatësia e tyre fetare spikati edhe në vizitat që bënë tek njëri tjetri dhe tek qytetarët e thjeshtë muslimanë. Duhet theksuar se Bajrami i afron muslimanët më shumë me njëri

tjetrin, duke forcuar unitetin në mes të tyre, unitet aq i domozdoshëm sot për muslimanët në Turqi dhe në të gjithë Botën Muslimane e cila sot penalizohet dhe akuzohet për veprime që nuk kanë të bëjnë me muslimanët dhe vetë fenë islame.

## ERDOGAN PER NJE SULM MBI IRANIN

**A**xhensitë e lajme bëjnë të ditur se kryeministri i Turqisë, Taip Rexhep Erdogan, në një konferencë shtypi përpara se të bëjë vizitën e premtuar në Irani fqinj, ka komentuar zhurmën e madhe që po bëjnë fuqitë e mëdha, kryesisht ato bërthamore, për vënien në funksionin të një reaktori të ri bërthamor në Iran për të cilin Irani ka deklaruar se ky reaktor nuk ka si qëllim të funksionojë për një program bërthamor, sepse Irani i quan të tejkaluara

dhe të panevojshme armët bërthamore. Kryeministri turk ka deklaruar se në Lindjen e Mesme ka shtete që janë në njëjtën pozitë si Irani dhe nuk po i kritikon askush, duke lënë të nënkuptohet se ndaj Iranit po përdoren dy standarte, në trajtimin e programit të tij bërthamor i cili, si deklaroi qeveria iraniane, do të përdoret për qëllime paqësore. Ndërsa, në lidhje me mundësinë e një sulmi ushtarak ndaj Republikës Islamike të Iranit, kryeministri i Turqisë, Erdogan, dekla-

roi se një sulm i tillë do të ishte një fatkeqësi që do ta pësonin ato që do të sulmoheshin Iranin. Kryeministri Erdogan theksoi me tej se Turqia është e interesuar që në Lindjen e Mesme të ketë qetësi. Këto deklarata të kryeministrit turk tregojnë se Turqia është kthyer në një fuqi të tillë e cila ka një peshë të madhe diplomatike, ekonomike dhe ushtarake për të influencuar në rajonin e Lindjes së Mesme dhe më gjërë.

## BE DUHET TE MBAJE QENDRIM TE DREJTE NDAJ TURQISE

**M**inistri i jashtëm i Turqisë ka mbajtur një konferencë për shtyp gjatë vizitës që ai ka bërë në Hallandë ku ka deklaruar se Turqia nuk është dakort me qëndrimin e BE ndaj Turqisë duke i kujtuar asaj se duhet të mbajë një qëndrim të drejtë ndaj Turqisë. Ministri i jashtëm i Turqisë, Davutullu i kujtoi ministrit të jashtëm të Hollandës se nuk është da-

kort me deklaratën e tij sipas së cilës Turqia duhet të shpejtojë në bërjen e reformave. Turqia, theksoi ministri, Davutullu, ka bërë shumë reforma dhe po i bën ato me shpejtësi si është rasti i reformave për të drejtat e njeriut dhe ato në drejtësi, pa harruar edhe reformat që po bëhen edhe në fusha të tjera që prekin jetën politike dhe ekonomike të Turqisë. Por BE duhet t'i shohë me reali-

zëm këto reforma dhe t'i vlerësojë drejt ato. Në bisedimet e zhvilluara në Hagë dy ministrat diskutuan edhe për probleme të rëndësishme ndërkombëtare si ai iranian dhe probleme të tjera të rëndësishme me të cilat sot po perballlet politika ndërkombëtare ku roli i dy vendeve, sidomos i Turqisë është i një rëndësie të vecantë.

## INCIDENT I ERDOGANIT ME BODIGARDET AMERKANE

**N**ë informacionet e dhena nga stacioni radiofonik "Zëri i Turqisë" në gjuhën shqipe thuhet se ka ndodhur një incident i papëlqyer në mes të kryeministrit të Turqisë Taip Rexhep Erdogan dhe rojeve të tij me bodigardët amerikanë të ngarkuar të kishin në mbrojtje presidentin amerikan Obama. Ngjarja ka ndodhur në samitin që po mbahet në Nju Jork për problemet e ndryshimit të klimës në planetin tonë. Kryeministri turk është ndaluar nga bodigardët amerikanë që të hyjë në ndërtesën ku do të mbahej samiti duke e penguar z.Erdogan disa dhjetra metra para se të afrohet. Megjithatë rojet e kryemi-

nistrit turk u kanë thënë se bëhet fjalë për kryeministrin e Turqisë, amerikanët nuk kanë hapur rrugë duke e cuar situatën drejt konfrontimit të trupave turke me bodigardët amerikanë. Në këto momente, Erdogan është kthyer në hotelin ku kishte rezidencën e tij të qëndrimit. Me ndërrimin e bodigardëve nga ana e amerikanëve, gjendja është qetësuar dhe kryeministri Erdogan ka marrë pjesë në samit, por në shenjë proteste dhe si masë reagimi ai nuk ka pranuar të flasë në këtë takim, bisedë kjo që ishte planifikuar edhe kryeministrit të Turqisë. Nuk është hera e parë, kur kryeministri Erdogan mbron personalitetin e tij dhe inter-

esat e shtetit turk dhe ato të muslimanëve nga provokimet si ishte rasti i përplasjes së tij me presidentin e Izraelit, Perez, në Davos të Zvicrës dhe rasti i kundërshtimit të kandidaturës së sekretarit të përgjithshëm të Natos, Rasmundsen, i penalizuar nga Bota Islame për qëndrimin e tij në përkrahje të karikaturave kundër profetit Muhamedit a.s. Qëndrimi krenar i kryeministrit turk Erdogan mbetet një model i vlerësuar për mirë për të gjithë udhëheqësit e Botës Islame



# NJE VEPER E NDRITUR PER OSMANET MADHESHTORE

**N**dër botimet e shkëlqyera që ka bërë "Etika - Progres" një vënd nderi zë pa tjetër vepra "Osmanët" me autor, të nderuarin Osman Nuri Tobash, vepër që për lexuesin e sotëm dhe për atë që do të vijë pas, është një dokument i mbështetur në të vërteta historike të cilat janë dhe do të mbeten një material i pazëvendësueshëm njohës për lexuesin shqiptar dhe më gjërë, sepse i bën një portret realist madhëstisë së Perëndorisë Osmane, ide kjo e realizuar përmes prezantimit të sulltanëve gjigandë dhe të papërsëritshëm osmanë të cilët kontribuan politikisht, ushtarakisht, ekonomikisht dhe fetarisht për fuqizimin dhe lartësimin e Perëndorisë Osmane. Vepra ka dhënë portretin e sulltanëve osmanë duke i mbetur besnike hapësirës kohore kur ata ishin drejtues të kësaj Perëndorie madhështore duke i vlerësuar ata pikërisht nga kontributi që dhanë për lartësimin e kësaj Perëndorie. Është meritë e padiskutueshme e autorit të nderuar që sulltanët osmanë në vepër janë paraqitur me individualitetin e tyre të vërtetë, larg një klisheje shtampë që do të kishte cënuar karakterin realist të këtij botimi. Për lexuesin, vlera dhe madhështia e sulltanëve osmanë është e lidhur me kontributin e tyre të gjithanshëm për ta bërë te pavdekshme kete Perëndori e cila nuk pati si qëllim të saj eliminimin dhe rrenimin e popujve dhe të shteteve ku u vendos, por ajo marshoi vetëm përpara për përhapjen e fesë islame dhe të vlerave të saj universale. Pikërisht këtu finalizohet edhe qëllim madhështor i sulltanëve osmanë dhe i vetë strategjisë së kësaj Perëndorie i cili ishte mesazhi islam që merrte jetë edhe nga mijra misionarë islamë që i shoqëronin ushtritë e fuqishme osmane që triumfuan në të gjithë botën. E rëndësishme është se dhuna për të konvertuar popuj në muslimanë nuk ishte vepër e sulltanëve osmanë. Historia dëshmon se 4% e popujve që je-



tuan në Perëndorinë Osmane u konvertuan në muslimanë, në një kohë që, po të përdorej dhuna në konvertin, vështrë se do të mbetej kush jashtë fesë islame në hapësirat e kësaj perëndorie. Në vepren "Osmanët" i nderuari, Osman Nuri Topbash, na ka dhënë Sulltan Mehmetin e II që pushton Kostandinopojën, Selimin e Rreptë që pushton Egjiptin, Sulltan Sulejmanin madhështor që rrethon Vienën dhe të tjerë sulltanë që marshojnë përpara për t'ia rritë madhëstinë perëndorisë. Lexuesi e shikon qartë se sulltanët ndryshojnë nga njëri tjetri nga tiparet e karakterit që ata kanë. Por ata bashkohen në një pikë e cila është vlera e tyre që i bëri pjesë jetike të madhëstisë së vetë Perëndorisë Osmane. Vetë vlera është e zërthyer tek kontributi i tyre për ta bërë të përjetshme Perëndorinë Osmane. Pikërisht këtu, autori i vepërës, për të ruajtur shkallën e vërtetësisë, ka bërë edhe diferencimin e këtij kontributi në rrallët e sulltanëve osmanë. Duke kaluar me kujdes veprën nëpër duar, ne bindemi edhe për një të vërtetë tjetër që është edhe celësi i

suksesit të këtyre sulltanëve të pathyeshëm. Ata nuk mund të shkëlqenin dhe nuk mund të ishin të sukseshëm vetëm duke u mbështetur në dhuntitë e tyre personale. Ajo që i lartësoi ata në betejë ishte përkushtimi i tyre sublim fetar për të cilin ata ishin tejet të vendosur. Ishte pikërisht morali i lartë fetar që i kaloi sulltanët osmanë nga fitorja në një fitore tjetër edhe më madhështore. Autori i vepërës, i nderuari, Osman Nuri Topbash, do të theksojë se në drejtim të moralit islam sulltanët osmanë nuk bënë përjashtim. Në një gjyq Sulltan Mehmeti i II do të paraqitej si qytetarë i thjeshtë. Kurse Sulltan Selimi i Rrepte ishte i gatshëm ta ndalonte marshimin në Egjipt në se ushtarët do të kishin prekur pa leje frutat në kopshtet e vendasve. Duke lexuar veprën "Osmanët" të bën pershtypje jetëgjatësia e kësaj perëndorie e cila i ka kapërcyer 500 vitet, një kohezgjatje e rrallë në jetën e një perëndorie. Prandaj, ndër vlerat më të rëndësishme të kësaj veprë është se autori na ka treguar se kjo kohezgjatje e Perëndorisë Osmane e ka bazën tek qeveris-

ja e urtë dhe e drejtë e saj, aq sa sot janë të dokumentuara vlerësimet për veprimet e sulltanëve osmanëve të cilët respektuan religjonet e popujve me të cilët ata bashkëjetuan dhe njekohesisht u krijuan e mundësi këtyre popujve për të qenë pjesë e bashkëqeverisjes në shtetin osman. Një analizë të kujdesshme dhe realiste ka bërë autori i nderuar për periudhën pas rënies së Perëndorisë Osmane, duke e pershkruar kete renie si një fatkeqësi që u përgadit nga qëndra të rrezikshme judeo-kristiane të cilat rrenimin e Perëndorisë Osmane e quanin një goditje për vetë fenë islame. Prandaj, sot në hapësirat e ish-Perëndorisë Osmane nuk ka qetësi dhe vrasjet e muslimanëve atje janë bërë ngjarje të dites, pa harruar të shtojmë se pikërisht atje krimet "lulëzojnë" me lejen kriminelëve antimuslimanë, duke na kujtuar se vetëm Perëndoria Osmane ishte e aftë të qeveriste me drejtësi dhe të respektonte të drejtat e të gjithë popujve që jetonin në hapësirat e saj. Mendojme se vlerën e kësaj veprë ia rrit më tepër edhe niveli i lartë i përkthimit që kanë bërë grupi i përkthyesve pranë "Etika - Progres" i cili lartësohet edhe nga përdorimi i një gjuhe tejet të zgjedhur që e bën veprën të jete shumë pranë origjinalit të saj. Nuk duhet lënë pa përmendur nivelin cilësor të botimit i cili e ka bërë edhe më të pëlqyeshëm për lexuesin që, për hir të vërtetës, e ka mirëpritur këtë botim, duke e bërë atë veprën me të kërkuar nga të gjithë botimet e tjera që ka bërë deri tashti "Etika - Progres". Në vënd të epilogut do t'i uronim autorit dhe "Etika - Progres" që të sillnin përsëri pranë lexuesit libra të tillë që rritin shkallën e njohjes së lexuesit shqiptar për historinë e popullit turk me të cilin na lidhin religjoni i perbashkët i shumicës së popullit shqiptar dhe fije të pafundme të një historie të përbashkët.



# BIBLIOTEKA E VAKEFIT TE SHKODRES

**K**rahas medrezeve , Bushatllinjtë themeluan edhe biblioteke-ën e madhe të tyre të cilën ia dhuruan Vakëfit të Shkodrës. Kjo bibliotekë ishte ndër më të vjetrat e themeluar në Shqipëri nga fundi i shek. të 15 nga Mehmet Pashë Plaku. Pasardhësit e tij e pasuruan këtë bibliotekë me mijra volume që u sollën nga jashtë të cilat ishin arabisht, turqisht, persisht, frëngjisht. Shkrimtari i njohur anglez, Urqurhard, do të shkruante në një botim të tij se Mustafa Bushatlliu ishte një njeri serioz që pat mëkëmbur një bibliotekë me libra frëngjisht dhe turqisht të cilat ia fali Vakëfit të Shkodrës. Në bibliotekën e Vakëfit të Shkodrës ka patur mbi 3000 volume me libra fetarë , tekste shkencore, filozofike, historike dhe tematika dhe të tjera. Të tillë libra me vlerë ishin Historia e Ibni Halëduni , Historia e Xhevdet Pashës në 12 volume. Kurse botime filozofike kishte nga Ibni Sina, Imam Gazaliu. Kishte edhe vepra

originale në dorëshkrim. Në këtë bibliotekë ishte edhe libri i shkruar shqip i Tahir Efendi Gjakovës me titullin " Vehbije", duke shtuar këtu edhe librin Historia e Ahmet Pashë Dukagjinit e shkruar turqisht

Të gjithë librat vuloseshin me vulën personale të Mustafa Pashës, por më vonë u vulosën me një vulë që Mustafa Pasha e dërgoi nga jashtë, pasi ishte laguar nga Shkodra. Në vulë shkruhej kështu: "Mbështetja ime është Zoti dhe Ai është i mjaftueshëm\_ nga librat të cilat i ka bërë vakëf , i pervuajturi pranë të mirave të perëndisë nga viziri i quajtur Sherif Mustafa. Zoti është më i përhershmi" Vulën e mban-te kujdestari i Bibliotekës e cila kishte datën 1251(1831). Ndërtesa e Bibliotekës ka qenë përballë Medrezesë së Karamahmud Pashës. Para se të ndërtohej biblioteka, librat ruheshin në Bixhesten në raftet të pasacëm. Ndërtesa u ngrit pasi u largua Mustafa

Pasha i mundur nga ushtria osmane. Ndërtimi i kësaj bibliotekë tregon interesimin e Pashës për përhapjen e diturive në atdheun e tij. Ai e pat paisur bibliotekën me libra të zgjedhura që i blinte pa pyetur për cmimin e tyre. Biblioteka kishte libra që nuk ishin në biblioteka të huaja shume të njohura. Në vitin 1929, një grup orientalistësh gjermanë, gjatë vizitës së tyre në bibliotekë, kërkuan të blinin disa libra të rrallë në gjuhën arabe që nuk i kishin gjetur askund duke vënë në dispozicion shuma të mëdha parash, por që u refuzuan nga autori i veprës që në ato vite ishte administrator i Zyres së Vakëfit dhe kujdestar i Bibliotekës. Në këtë bibliotekë ka pasur libra të vulosura edhe nga vetë Kara Mahmut Pasha, gjë që verteton sa e vjetër është kjo bibliotekë. Kjo bibliotekë kishte dhoma dhe sallone ku mbaheshin librat dhe vend studimi për lexuesin. Biblioteka ka patur në fillim dy kujdestarë që ishin të detyruar

të respektonin rregulloren e hartuar nga vakflënësit.

Kur u caktua vali në Anadoll , Mustafa Pasha , pat deklaruar se do të ishte më i kënaqur të ishte një drejtor shypshkronje se sa një vali në një vend të huaj. Kjo bibliotekë kaq e pasur , me mijra vëllime të kulturës islame dhe të përgjithshme, filloi të dëmtohej nga funksionarët e Myftinisë që nuk zbatonin rregulloren e hartuar nga veziri Bushatllij që ishte edhe dhuruesi i saj për Vakëfin. Librat ranë në duar të personave që i merrnin dhe nuk i kthenin më, ose kthenin një volum dhe tjetrin jo.

Duhet theksuar se ndërtesa e Bibliotekës ishte bërë qëndër kuvendesh patriotike ku mbledhej Dega e Lidhjes së Prizrenit. Aty jepeshin edhe vendime për mbrojtjen e At-dheut.

*Materjali është marrë nga botim "Shkodra dhe motet" me autor Hamdi Bushati*

## EKZPOZOHET NE TIRANE BIBLIOTEKA E BUSHATLLINJEVE

**M**e 1 Tetor 2009, në një nga sallat e bibliotekës kombëtare u hap një ekspozitë kushtuar Bibliotekës së Bushatllinjëve . Me këtë rast u organizua një ceremoni-kokteil. Fjalën e rastit e mbajti drejtori i bibliotekës, Aurel Plasari i cili theksoi dy momentet kryesore të kësaj ekspozite. Së pari ajo është një evendiment i rëndësishëm kulturor, sepse kjo bibliotekë për vjetërsinë e saj dhe vlerat që ajo ka bën pjesë në trashigimninë e kulturës evropiane. Ai koleksion i redaktuar në 150 mijë njësi bibliotekare të dorëshkuara, është faktikisht 1\ 200 pjesë e Bibliote-

kës së famshme të Bushatllinjëve.(shek XV-XIX), shpëtuat fatmirësisht rrebesheve të kohës. Librat e kësaj bibliotekë madhështore përmbajnë tekste filozofie , fetare, gjuhësore , letersie, administrative, retorikë të cilat ekspozohen për herë të parë në publik. Oratori gjithashtu shprehu mirënjohje ndaj punës së dy orientalistëve shqiptarë të ndjerëve Hamdi Bushati dhe Zyber Bakës që punuan për identifikimin e veprave dhe sidomos Hamdi Bushati për informacionit e hollësishme përmes veprës "Shkodra në mote", si administrator i fundit i kësaj bibliotekë para se

ajo të transformohej në Tiranë në vitin 1927. Pastaj e mori fjalën z. Nexhmi Bushati i cili, në emër të Shoqatës " Kara Mahmut Pasha" përshëndeti të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre në këtë aktivitet. Gjithashtu ai përgëzoi Bibliotekën Kombëtare për këtë nismë të lavdërueshme dhe me këtë rast u bënë disa dhurata simbolike për Bibliotekën Kombëtare. Të pranishmit patën rastin të shikojnë larminë tematike të librave , vjetërsisë e tyre në kohë, kaligrafinë e përdorur dhe ornamentet e kushtueshme të shumë nga librat e ekspozuar. Të pranishmit e prekën me dorën e

tyre faktin se Vezirët Bushatllinj nuk kishin qenë vetëm ushtrakë dhe burra shteti, por edhe njerëz të ditur dhe të kulturuar, përkrahës të zhvillimit shpirtëror dhe kulturor . Drejtori i Bibliotekës Kombëtare premtoi se kjo ekspozitë do të hapej edhe në Shkodër duke u dhënë mundësinë qytetarëve shkodranë që të shijojnë dhe të vlerësojnë këtë thesar të pacmuar të kulturës shqiptare sic është Biblioteka Madhështore e Bushatllinjëve.

*Nexhmi Bushati*

# INFORMACIONE NGA BOTA ISLAME

## INCIDENT I ERDOGANIT ME BODIGARDET AMERKANE

“Ne duam që kancelarja Merkel dhe qeveria e saj e re të na japë drejtësi,” thotë Nadim Elias- shef i Këshillit të Lartë të Muslimanëve në Gjermani për Islamonline. Ne dëshirojmë të mendojmë se është një qeveri për të gjithë njerëzit pa marrë parasysh dallimet etnike, fetare dhe kulturore. Të gjithë duhet të ndjejnë se interesat e tyre janë duke u mbrojtur nga qeveria.” Zonja Merkel, 55 vjeçare, siguroi edhe një mandat katër vjeçar pasi partia e saj Kristian De-

mokrate dhe Bashkimi Social Kristian fituan 33.8% të votave. “Duam mundësi të njëjta për punësim,”- thotë Ibrahim el Zajati, drejtor i Kuvendit Islam në Gjermani., duke argumentuar se disa punë nuk mund të arrihen nga muslimanët, ose për shkak të moskualifikimit të nevojshëm, ose për shkak të racizmit ndaj tyre.” Ai tha se qeveria duhet të tregojë më shumë vëmendje për punësimin e muslimanëve, në veçanti në institucionet shtetërore. “Janë

më shumë se 4 milion muslimanë në Gjermani, përfshirë aty 220.000 vetëm në Berlin”. Muslimanët nuk duhet të shikohen si një kërcënim për vendin, aponjëburimdestabiliteti,”- tha Elias nga Këshilli i Lartë Musliman në Gjermani. Qeveria nuk duhet të përqendrohet vetëm në miratimin e ligjeve që kufizojnë të drejtat e muslimanëve dhe t’i shkulin i ato.” Gjithashtu dëshirojmë që qeveria të merret me Islam në një mënyrë si me besimet tjera siç janë krishterim dhe ju-

daizmi,”- tha Zajati. Qeveria duhet që ta njohë Islam si fe zyrtare, duke lejuar që Islami të mësohet në shkollat dhe të lejohet transmetimi Islam në media. Gjithashtu edhe ndërtimi i xhamive është bërë i vështirë në Gjermani dhe shumë vende evropiane gjatë viteve të fundit, për shkak të fushatave të partive të djathta. Qeveria e re duhet të inkurajojë komunat për lehtësimin e dhënies të lejeve për ndërtimin e reja të xhamiave.

## ME BIÇIKLETË NGA BOSNJA PËR NË HAXH

Ermin Lipoviq, kryetar i klubit të sporteve ekstreme Limit, pas shumë aktiviteteve si maja më e lartë afrikane Kilimanxharo, maratona Bihaç - Srebrenica etj, është duke përgatitur diçka që askujt deri më sot nuk i ka shkuar përdore. Në bisedë për media, për herë të

parë shfaqti publikisht planin që vitin e ardhshëm bashkë me tre kolegët e tij të shkojnë në haxh me biçikleta. Këtë tentim të guximshëm ka kohë që planifikon, por për shkak të kushteve financiare këtë dëshirë të madhe jetësore që me biçikletë ta vizitojë vendin

e shenjtë në zemër të Arabisë Saudite nuk kishte dëshirë ta publikoj. Kjo do të ishte hera e parë që dikush nga Bosnja e Hercegovina të shkojë me biçikletë në haxh. Dëshira dhe vullneti janë të pranishëm, por nuk varet gjithçka nga ne, gjërat varen edhe nga proce-

durat burokratike, e veçanërisht rreth vizave për Arabinë Saudite. Ne jemi të gatshëm, por duhet të presim lejet, dhe vitin e ardhshëm të nisemi”, thotë Lipoviq.

## TAXHIKISTANI ME XHAMINË MË TË MADHE NË BOTË

Duke synuar të jetë qendra më e madhe kulturore dhe historike e Islamit në Azinë Qendrore dhe në botë, Taxhikistani po planifikon për ndërtimin e xhamisë më të madhe në botë.

“Xhamia pritet të akomodojë rreth 150.000 njerëz,”- tha zëdhënësi i presidentit Taxhikistanes sot për gazetën “Financial”

Times”. “Ndërtimi i saj pritet të fillojë në Dushanbe në tetor.”

E financuar nga shtetet e Gjirit Arab, Katari dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, xhamia do të jetë e gatshme deri në vitin 2014. Duke pasqyruar arkitekturën tradicionale të Taxhikistanit, xhamia do të ndërtohet në një hapësirë prej 7.5 hektarë në qendër të kryeqytetit Dushanbe.

“Xhamia do të zbkurohet me një minare madhështore, shtatë shtylla të pikturuara, që do të simbolizojnë shtatë hapat e krijimit të botës nga Zoti dhe shtatë dyert për në xhenet, me burime uji dhe fontana që tregojnë për këtë vend si vend i ujit të pastër,”-shtoi zëdhënësi. Vendi i adhurimeve muslimane do të ketë edhe salla takimi të nivelit të lartë.

Ky projekt madhështor do të përfshijë gjithashtu ndërtimin e një Universiteti Islamik përveç xhamisë. Taxhikistani, që është një nga pesë vendet e ish-Bashkimit Sovjetik në Azinë Qendrore, fitoi pavarësinë në vitin 1991 dhe ka një popullsi 90% muslimane.

## MUSLIMANËT FALIN XHUMANË PARA KONGRESIT

Në Kapitol Hill të premtene u mbajt “Dita e Unitetit dhe e Lutjeve muslimane”.

Rreth 3.000 njerëz u mbledhën të premtën në mëngjes në lëndinën para Kongresit Amerikan me qëllim të faljes

së namazit të xhumasë.

“Ne jemi muslimanë të mirë,”- tha një nga organizatorët, Imam Ali Jaaher nga Xhamia Dar-ul-Islam në Elizabeth të Neë Jersey: “Ne punojmë, ne paguajmë taksat.

Ne jemi muslimanë të cilët me të vërtetë e duan këtë vend.” Organizatorët thanë se kishin shpresuar se do të merrnin pjesë 50.000 besimtarë për faljen e namazit këtë pasdite nga ora 13:00. Por ata thanë se shumë besimtarë janë

frikësuar nga ndonjë reagim ndaj organizimit. Disa grupe konservatore krishtere e kishin quajtur faljen e namazit të xhumasë para Kongresit Amerikan antikrishtere dhe antiamerikane.



## PERSERI NE SKENE DALIN TERRORISTE ISLAMIKE

Thujse të gjithë mdiat ndër-kombëtare duke përfshirë edhe mediat tona që i mbajnë ison mediave të huaja kanë dhënë një informacion që ka munguar për pak kohë në hapësirat e tyre sipas të cilit Greqia po rrezikohet nga terroriste islamiqe të cilët sipas mediave që u referohen burimeve të shërbimeve sekrete amerikane, izraelite dhe atyre libaneze, po përgaditen të godasin qendra të rëndësishme të shteteve më të mëdha evropiane. Lajmin e ka dhënë një nga gazetatat më të mëdha greke sipas të cilës qeveria e re greke e Papandreut betejën e parë duket se do ta bëjë me islamikët një term sa akuzues aq edhe i shpikur për

të penalizuar muslimanët, sepse do të mjaftonte emërtimi terroristë pa qenë nevoja që t'u shtohet edhe nofka "Islmikë" por që duket se këtu është edhe qëllimi dhe strategjia e atyre që lakojnë informacione të tilla duke i vënë ata si kryefjalë e lajmeve të ditës. Duket se Greqia ka shumë gjynahe për të larë sepse nuk po e lënë rehat zjarret, anarkistët me shkatërrimet e fundit që sollën votimet e parakohshme dhe së fundi ato po kërcënohen (kështu po informohemi) nga gpditjet e terroristëve që kësaj rralle qenkan islamike, më të rrezikshmit e të gjithë terroristëve. Kjo që komentuar më lart ka të bëjë vetëm me lajmin mediatic që mediat i servi-

rën publikut, një liri kjo që është pronë edhe e mediave për të servirë informacione sidomos ata që t'i ngrejne qimet e flokëve përpjetë nga frika e asaj që pritet të ndodhë. Por informacionet që gatohen dhe mveshen me mantel fetar janë me dy teha dhe kanë edhe prapavijë të qëllimshme për të penalizuar muslimanët që individë dhe popuj në të katër anët e planetit të frikëohen nga islami si djalli nga temjani duke bërë që muslimanët të patentohen si terroristë sepse epitete "Islamike" penalizon një religjon që ka thujse 1 miliard e gjysmë banorë të planetit. Për fat të keq lajme të tilla rrezatojnë për keq edhe në Shqipëri ku elementi musliman

kap shifra mbi 70%. Flitet për tolerancë ndër-fetare dhe mediat gadsin pa mëshirë këtë tolerancë duke i nxirë muslimanët me termin terroristë islamike, sepse komuniteti musliman është si theksuam 1,5 miliard banorë në botë dhe pjesë e këtij komuniteti janë edhe muslimanët shqiptarë. Prandaj u duhet "tërhequr veshi" mediave shqiptare dhe atyre që janë pas tyre që "mos peshkujne informacione me terroriste islamike" sepse informacione të tilla mund të kthehen kundër atyre që u hedhin rrjeta të tilla merimange në qafë muslimanëve.

## XHAMIA T E MAQEDONISE DHE RAKETAT E IRANIT

Në emisionin opinjon, të cilin e transmeton stacioni televiziv "Klan" dhe që drejtohet nga analisti Blendi Fevziu, ditët e fundit, në një panel me analistë dhe politikanë shqiptarë dhe maqedonas, u diskutua për qëndrimin e Enciklopedisë Maqedonase ndaj autoktonisë të shqiptarëve të Maqedonisë. Telespektatorët, që e ndoqën emisionin, dalluan që në momentin e parë se në diskutime do të kishte dy kampet të kundërta të cilët realisht edhe në panel jo rastësisht ishin vendosur përballë njëri tjetrit. Fatos Lubonja Maks Velo dhe Piro Misha diskutonin nga krahu që i mbanin ison direkt ose indirekt pretendimit të maqedonasve për konkluzionet e enciklopedisë që shqiptarët i quan të ardhur nga mali dhe që kanë uzurpuar tokat

, shtëpitë dhe hapësira të tjera të maqedonasve. Sidomos shqetësuese ishin ndërhyrjet e Fatos Lubonjës dhe të Maks Velos që u drejtoshin Mendu Thacit, Ali Aliu dhe Gjergj Zhejin me përemrin "keta qëndrim ky sa armiqësor aq, edhe antishqiptar, qëndrim që irritoi me të drejtë anën tjetër të panelit të cilët e quajtën këtë qëndrim dicka të tmerrshme. Sidomos, Maks Velo i akuzoi shqiptarët e Maqedonisë se ata janë shkaktarë të acarimit të mardhjeve ndër-etnike dhe se, sipas Maks Velos, shqiptarët duhet t'i binden qeverise maqedonase se është qeveria e tyre. "Ju jeni ata që keni vuarë policët maqedonas në mes të ditës" iu drejtua ai Mendu Thacit dhe Ali Aliut që ishin në panel përballë këtij të ftuari antishqiptar. Por, akuzat e Maks Velos kundër shqiptarëve morën karakter

ter fetar, kur ai tha se është përkatësia fetare muslimane shkaku i përplasjes në mes të shqiptarëve dhe maqedonasve. Maks Velo do të deklaronte publikisht se fshatrat shqiptare në Maqedoni janë të mbushura me xhamia që mua më ngjajnë me raketat e Iranit theksoi ky antimusliman i njohur në mediat dhe jetën e shqiptarëve. Për fat të keq, Maks Velo nuk arriti të fshehe prapavijën e tij antishqiptare dhe antimuslimane, sepse deklaroi që është një fans i njohur i këngëtarit serb Bregovic i njohur për këngët e tija antimuslimane dhe antishqiptare të cilin ia pat dhënë celësin e Tiranës një variat më i avancuar se Maks Velo, kryetari i bashkisë së Tiranës, Edi Rama. Paneli i të dy krahëve nuk iu kundërvu këtyre deklaratave kaq të rrezikshme të Maks Velos duke

treguar se për mediar shqiptare sot është e ndaluar të mbrohen muslimanët shqiptarë, ose të huaj, në një kohë që janë të gatshëm të japin informacione kundër muslimanëve duke "gërmuar" gjithandë për të siguruar informacione të tilla. Nuk e dimë saktë përse ky Maks Velo ftohet në panele të tilla, ku nxerr helmin e tij antishqiptar dhe antimusliman. Gjithashtu të habit fakti se të nesërmen e këtij emisioni asnjë nga gazetatat nuk mori mundimin t'i kujtojë lexuesit për qëndrimin i Maks Velos dhe të Fatos Lubonjës në panelin e opinjonit ku ata haptas shpalosën platformen e mendimit të tyre antishqiptar dhe në rastin e Maks Vepos edhe antimusliman

Alban Kastrati

## KERKOJE DITURINE QE TE BEHESH I DITUR

E gjeta... e gjeta... e gjeta! Ishin thirrjet e bashkëbiseduesit i cili kishte humbur dicka që kur e gjeti kishte qenë vetëm një kopsë xhakete. Herë pas herë njerëzit humbasin sende me vlerë që herë i gjejnë dhe herë nuk arrijnë që t'i gjejnë, sepse kjo lidhet me shumë arsye. Por, është dicka tjetër që njeriu duhet ta kërkojë gjithë jetën. Kjo është dituria, një vlerë e cila e lartëson njeriun dhe sidomos besimtarin musliman. Në një thënie profetike thuhet "Njeriu duhet ta kërkojë diturinë si një dicka që i ka humbur" Fjala e parë e Ku-

ranit Famëlartë është "Ikre" që do të thotë: lexo shkruaj mëso, kërkesa këto që e pozicionojnë besimtarin musliman që për objekt të jetës së tij të jetë përvetësimi i diturisë. Besimtari musliman kur falet dhe vë kryet në sexhde, e ndjen vehtën të lumtur nga ai veprim që po kryen, sepse po krijon lidhje me Allahun xh.sh. Duhet theksuar se besimtari musliman për t'u formuar dhe për t'u bërë i ditur ai lexon Kuranin Famëlartë, mediat eshkruara dhe përcjell ato vizive, pa harruar se ai i vë shumë rëndësi leximit të literaturës islame. Në kërkim të

dijes, besimtari musliman ditën e xhuma ndëgjon edhe hytben që mban imami në xhami. Gjithashtu besimtari musliman i vë vehtes detyrë që të mësojë gjuhën arabe që të lexojë në origjinal Kuranin e Madhërueshëm. Këto tregues dhe të tjerë tregues janë rrugët ku duhet të piketohet besimtari musliman që të kërkojë dije aq e nevojshme kjo që ai të jetë një besimtar i formuar dhe i ditur. Do të jenë këto dije që atij do t'i shërbejnë edhe për t'u ballafaquar më mynafikë, ateistë dhe të tjerë që shkallën e dijeve dhe besimin e kanë të ulët. Urtësia po-

pullore na ka lënë thënia të rralla që vlerësojnë rëndësinë e dijës, sidomos për besimtarin. Një nga këto thënie është kjo: "Ah sikur ta dinim çfarë gjeje ka humbur, kujt i ka ikur mundësia për t'u paisur me dije dhe kush e ka marrë dijen, kush e ka kuptuar dijen dhe kush e ka fituar dijen. Muslimani është dëshmitar për një thënie të artë kuranore i cila i referohet dijës "Thuaj a janë të barabartë ata që dinë dhe ata që s'dinë" (El Zymer)

Kasem Zylja

## NJE DIALOG HYJNOR NE MES ZOTIT DHE NJE FEMIJE

Fëmija që do të lindte flet me Zotin një ditë para se të vinte në këtë botë:

- Zoti im. Do të shkoj në botë dhe nuk di se çfarë do të bëj aty.

- Unë kam krijuar një melek që do të kujdeset për ty \_ i thotë fëmijës Zoti i Madhërueshëm

- Zoti im . Unë nuk e di gjuhën e tyre dhe nuk di si do të merrem vesh dhe si do të komunikoj me njerëzit atje

- Meleku që kam krijuar unë për ty do ta mësojë ty gjuhën e tyre\_ i përgjigjet Zoti i Madhërueshëm.

- Zoti im . Me sa kam ndëgjuar në këtë botë ka shumë gjëra të këqia.Si do t'ia dal mbanë unë nuk e di.

- Meleku që unë kam krijuar për ty do të mbrojë nga të gjitha të këqiat e kësaj bote\_ i përgjigjet Zoti i Madhërueshëm.

- Zoti im. Si do të kthehem unë prap tek Ti?

- Meleku që unë kam krijuar për ty do të tregojë se si ti do të vish përsëri tek unë\_ i përgjigjet Zoti i Madhërueshëm.

Vijnë melekë të tjerë dhe i kujtojnë fëmijës se ka ardhur koha që të shkojë në botë dhe fëmija i drejtohet Zotit për herë të fundit.

- Zoti im. Si quhet meleku që Ti ke krijuar për mua?

- Nuk ka rëndësi për ty emëri i melekut që Unë kam krijuar për ty,por ti do ta thërrasësh ata NENE.

## ALLAHU XH.SH. NA UDHEZON TE RESPEKTOJME PRINDERIT

Në këtë material është dhënë një bisedë që një prindër i drejton në formën e një fabule djalit të vet të cilit i kujton detyrimin hyjnor për të respektuar prindërit e tij.

\_ Ditën që do të më shohësh të vjetër dhe unë nuk do të jem ai që kam qenë dikur, ti përpigu që të më kuptosh.

\_ Në se unë bëhem i papastër duke ngrënë dhe nëse unë nuk mund të vishem, ti të kesh durim dhe kujto orët të cilat unë i kam kaluar duke të mësuar ty që të vishësh dhe mos të bëhesh i papastër gjatë të ushqyerit.

\_ Nëse gjatë një bisede me ty unë i përsëris fjalët ti mos më ndërpre, por më ndëgjo, sepse kur ti ishe i vogël unë të kam përsëritur disa herë një tregim deri sa ty të merrte gjumi.

\_ Kur unë nuk dua të bëj një dush mos më qorto ,sepse kur ti ishe i vogël unë shpikja njëmijë marifete që ti të bëje një dush.

\_ Kur ti sheh paditurinë time në përdorimin e teknologjisë se re mos më shiko duke qeshur dhe duke u tallur, sepse edhe unë kam mësuar shumë gjëra që ti nuk imdije më parë.

\_ Nëse unë ndonjëherë nuk dua të ha ti mos më detyro, sepse unë e di vetë se kur duhet të ha dhe kur nuk duhet të ha.

\_ Kur këmbët e mia të lodhura nuk më lejojnë të eci , ma jep dorën tënd sikur ta kam dhënë dikur unë kur ti sa po kishe filluar të ecje.

\_ Dhe kur një ditë unë do të themty se nuk dua të jetoj më dhe dua të vdes, ti mos u zemro me mua , sepse duhet të kuptosh se vitet e mia tashti uk janë jetesë por janë mbijetesë.

Një ditë ti do ta kuptosh se pavarësisht nga gabimet e mia, unë gjithmone kam dëshëruar të mirën tënde.

\_ Ti nuk duhet ta ndjesh vehten të pikëlluar dhe të zemruar kur më sheh pranë teje, sepse duhet të jesh gjithmonë pranë meje që t më ndihmosh, si të ndihmova unë dikur ty kur ishe i vogël.

\_ Më ndihmo që të eci dhe ta maroi rrugën time me dashuri dhe durim, sepse unë do të paguaj ty biri im me buzëqeshje dhe dashuri të pamasë të cilën unë e kam patur për ty gjithmonë

Të dua biri im i dashur



## Space-center

Qendra e internetit space-center ju ofron:

- internet te shpejte,
- shperndarje interneti,
- programe te ndryshme,
- cd, dvd, mp3,
- servis kompjuterash
- printime, skanime, etj.

Te gjitha keto me nje sherbim cilesor e te kulturuar.  
Jemi hapur cdo dite nga ora 08:00 deri 23:30.

Adresa: pallati xhenis pas rektoratit te universitetit  
"luigj gurakuqi", kati I

Kontakte:

- e-mail: spacecenter@live.com
- Cel. 0693253723 / 0672944162

# A ESHTË E VERTETË KJO Z. KRYEMINISTER I SHQIPËRISE

Gjatë një interviste të dhënë tek media vizive "Klan", kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, iu përgjigj edhe disa pyetjeve të drejtuara nga teleshikuesit që po e ndiqnin direkt intervistën e tij në "Tv Klan." Një telespektator i kujtoi Sali Berishës se religjoni katolik i kishte dhënë Partisë Demokratike, në zgjedhjet e 28 qershorit, 14 deputetë katolikë, kurse Partia Demokratike, si shperblim, nuk kishte angazhuar asnjë ministër nga rrallët e religjionit katolik. Kryeministri Berisha, pasi bëri një pauz, për të peshuar më mirë përgjigjen, e cila kuptohet se nuk ishte e lehtë, pasi ishte krejt ballore dhe pa i rënë anash, deklaroi se kjo ish-

te e drejtë dhe është ndër difektet që ka sot qeveria e re e cila nuk ka asnjë deputet katolik në qeveri, duke nënkuptuar se në një moment të mundshëm do të ndreqej ky difek i qeverisë së re, ku në koalicion tashmë militon edhe e majta e Ilir Metës. Duke u përpjekur të qetësojë telespektatorin që idrejtoi pyetjen dhe shumë të tjerë si ai, Berisha bëri një pohim "të fortë" duke thënë se Partia Demokratike e ka bazën e saj tek religjoni katolik. Ky pohim është sa i cuditshëm, aq edhe i papërgjegjshëm, sepse kontributet në politikë nuk bëhen mbi baza religjoni, por mbi baza perkushtimi dhe mbi baza vlerash të cilat pastaj sjellin në kuvend deputetë dhe në qeveri

ministra, duke vazhduar me difektet, ku sjellin nëpunës të rangjeve të ndryshme. Nuk mund të themi me siguri cili ishte qëllimi i këtij pohimi provokues i Sali Berishës i cili po tjetër që ka lënë një shije të keqe tek ata që e përcollën këtë intervistë. Por, një gjë tashtë është e sigurtë, kur bëhen pohime të tilla me zarar. Për demokraci kanë inspiruar gjithmonë në Shqipëri si katolikët, muslimanët dhe ortodoksit dhe se Partia Demokratike nuk mund ta ketë kurrë mbështetjen vetëm tek religjoni katolik, sepse në një rast të tillë ajo do të quhej parti demokristiane, në një kohë që ajo vlerën e vërtetë e ka tek kontributi i tre religjoneve të cilët e freskojnë atë me anëtarë të rinj

dhe me kuadra e specialistë të rinj, për t'ia rritë asaj vlerat dhe për t'ia çuar më tej edhe vetë arritjet. Është e qartë se në këtë kontribut rol të rëndësishëm luan pa tjetër edhe përqindja që ka secili religjon në Partinë Demokratike, përqindje këto të njohura tashmë edhe publikisht përmes statistikave që i trajtojnë këto probleme. Prandaj, do të ishte mirë që vetë kryeministri Berisha të merrte informacione më të sakta për kontributin e religjoneve në Partinë Demokratike, nëse ai do të dëshironte të përdorte si masë vlerësimi për kontributin në këtë parti religjionin fetar.

**Selim Gokaj**